

# KOSOVARI

Ballina: Albert Gjuka

Familja  
me 13 fëmijë  
në një dhomë

Kurrë  
s'ka me u bë  
mirë

SHQIPTARI  
**ALBERT GJUKAJ,**  
XHENTËLMENI MAESTRO  
I KËPUCËVE LUKSOZE



Personalitet tona  
me gratë mise

Beart Rexhepi  
zbulon njeriun  
e zemrës

Më mirë  
me e pas burrin  
homoseksual  
se dreq

S'ka ditë  
pa një dhunim





DINO  
QERAMIKA

STATUARIO  
BLANCO



60x  
120cm

12€ NË 6.50€

ZBRITJE





## Naile Dema, gazetarja serioze

Edhe Naile Dema, qëkur ishte studente në Fakultetin e Gazetarisë "Faik Konica" në Prishtinë, hapat e parë në gazetari i bëri në Revistën tonë, "Kosovarja".

Ndërkaq, pastaj, me kryerjen e fakultetit, punoi në gazeta ditore dhe në Televizionin "Klan Kosova", ku ndodhet edhe tash.

E qetë, e natyrshme dhe, mbi të gjitha, e sigurt për atë që thotë para kamerës. Kjo është Naile Dema-Selmani prezantuese e lajmeve në "Klan Kosova".

Ajo një kohë të gjatë e ka udhëhequr emisionin "Ora e Fundit" në "Klan Kosova" dhe i ka dhënë shumë fuqi emisionit të shumë shikuar.

"Gazetaria, çfarë do lloj qoftë, është goxha sfiduese (po marr guximin të them, meqë kam punuar edhe në gazetë dhe në radio).

Dhe, pikërisht për këtë shkak, që më sfidon çdo ditë, e dua shumë këtë profesion.

Por, gazetaria në televizion është më e veçantë, sidomos nëse je në transmetim direkt, çka domosdoshmërisht të ekspozon ndaj lloj-lloj situatash, është sfiduese, por njëkohësisht e magjishme!", tha në një intervistë kohë më parë. Por, kohëve të fundit, Nailen më shumë e shohim si moderatore në ditarin televiziv të "Klan Kosovës".

E, si çdo herë, paraqitja e saj është shumë serioze.

## Valdete Osmani, gazetarja me reportazhin më të mirë

Valdete Osmani, që në kohën kur ishte studente në Fakultetin e Gazetarisë "Faik Konica" në Prishtinë, shkriu met e para gazetareske i bëri në Revistën tonë, "Kosovarja".

Prej vitit 2004 e hasim në gazeta ditore, pastaj si gazetare e lajmeve në KTV, korrespondente e rregullt e Televizionit "Top Channel", ndërkaq prej vitit 2014 në RTK.

Puna e saj është shpërblyer dhe vlerësuar nga organe të OKB-së, Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës dhe BIRN (Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Hulumtuese).

Në vitin 2016 është nderuar me çmimin vjetor për reportazhin më të mirë televiziv për diasporën nga Ministria e Diasporës.





Fshati Nasalë

# Në Nasalë të Gjilanit disa vjet pa asnjë martesë!

*Fshati Nasalë i komunës së Gjilanit po boshatiset çdo ditë e më shumë. Kjo edhe është arsyeja pse në këtë fshat ka shumë pak të rinj, andaj nuk ka edhe martesë...*

Aktualisht në Nasalë të Gjilanit kanë mbetur edhe pak familje, rreth 30 sosh. E, si pasojë e boshatisjes së fshatit në shkollë janë pak nxënës. Shumica e banorëve jetojnë në mërgim. Ndërkaq, këta që kanë mbetur aty ankohen se janë lënë pas dore nga

pushteti komunal. Megjithatë, komuna i asfaltoi rrugët kryesore të fshatit dhe gjendja ndryshoi për të mirë. E, disa nga banorët e fshatit Nasalë me vetëfinancim e kanë shtruar një pjesë të asfaltit para shtëpive të tyre, në mënyrë që të lidhen me rrugën kryesore. Por, banorët problemin më të madh e kanë me mungesën e ujit të pijes.

## NË VEND TË UJIT TË PIJES DOLI UJI MINERAL!

Para disa vitesh është hapur një pus për t'i furnizuar banorët me ujë, por uji ka dalë mineral dhe i nxehtë rreth 30 gradë celsius. Uji i fshatit Nasalë konsiderohet prej

shumë njerëzve si ujë shërues për shumë sëmundje. Andaj, të shumtë janë njerëzit që vijnë edhe prej fshatrave të tjerë për të marrë ujë për shërimin e sëmundjeve të ndryshme, si: gurët në idhëz, sëmundjet reumatike etj. Ky ujë shërues ka lidhje me banjën e Kllokotit.

**HUMBËN MARTESAT!**  
Por, e keqja kryesore e këtij fshati është se, kështu, si është gjendja tash, së shpejti do të mbetet pa banorë, sepse shpërngulja nga ky fshat është shumë e madhe. Por, edhe pse në këtë fshat jetojnë ende disa familje, banorët thonë se fshati do të mbetet pa banorë, meqë ka disa vjet që askush nuk është martuar!



# S'ka ditë pa një dhunim!

*S'ka ditë që kronika e zezë në Kosovë të mos shpalosë informacione të tmerrshme të dhunimeve...*

Kosova nuk ka mësuar mjaftueshëm nga gjendja e luftës në vitin 1999, kohë kur në procesion e dhunimeve të tmerrshme kanë kaluar mbi 22 mijë femra shqiptare të Kosovës, sipas statistikave të konfirmuara ndërkombëtare.

Sot, në shtetin më të ri të Evropës, në Kosovë, përsëri është bërë temë numër një dhunimi!

Në këtë segment prinë dhunimi i të miturave!

Lajmi i fundit se në Gjakovë është dhunuar një dhjetëvjeçare, është tronditës.

Një vajzë e mitur është abuzuar dhe dhunuar nga disa persona të panjohur, në lokacione të ndryshme.

E mitura është deklaruar në Policinë e Kosovës, në prezencë të akterëve të nevojshëm, ku ka treguar për abuzimin dhe dhunimin që i është bërë nga disa persona.

Me këtë rast Policia e Kosovës bëri të ditur se lidhur me rastin janë arrestuar një burrë dhe një grua.

Raportohet se gruaja e arrestuar është nëna e të miturës, ndaj së cilës është iniciuar rasti "Keqtrajtim apo braktisje e fëmijës".

Para pak kohësh ishte, gjithashtu, tronditës lajmi se në Prishtinë ishte dhunuar

një njëmbëdhjetëvjeçare nga disa persona dhe atë në mënyrë sistematike, për çka pesë vetë janë arrestuar.

E, rasti më i ri, kur edhe po e bëjmë këtë shkrim, është ai i Janjevës së Lipjanit.

Është arrestuar një person nën dyshimin se ka sulmuar seksualisht një të mitur.

Sidoqoftë, asnjë qytet i Kosovës nuk është i kursyer nga dukuria e dhunimit. Nuk ka ditë e që nuk flitet për dhunime!

Pra, janë bërë të përditshme dukuritë e dhunimeve që po ndodhin në Kosovë.

E, kush duhet ta thotë fjalën vendimtare për këto raste?

Policia është institucioni i sigurisë, që merret me procedimin teknik të rasteve, duke e ndërlidhur dukurinë me prokurorinë.

Sidoqoftë, policia, pa dyshim, ka edhe raste që i parandalon, kuptohet, kur është e informuar me kohë.

## SI TË PARANDALOHEN DHUNIMET?

Qeveria e Kosovës, kushdo që të jetë në pushtet, duhet t'i zhvillojë mekanizmat adekuat social të vetëdijesimit të fermave dhe, në përgjithësi, për të mos u bërë viktimë e këtyre dukurive.

Në shkolla duhet të flitet për këtë dukuri të shëmtuar.

Qendrat psikologjike duhet të ngritin zërin në stopimin e kësaj dukurie.

Shoqatat dhe instancat tjera sociale, qeveritare e joqeveritare, duhet të merren me këtë temë.

Por, para së gjithash, duhet trajtim dhe shqyrtim real pse po ndodh kjo dukuri në shoqërinë tonë?!

E, përgjigjen më të mirë mund ta japin

organet e rendit, në bashkëpunim me instancat sociale, meqë janë më afër zhvillimeve të caktuara që e kanë kapluar shoqërinë tonë.

Por, për ta parandaluar këtë deformitet patologjik shoqëror, gjithashtu, organet dhe instancat duhet t'i shqyrtojnë ndryshimet ligjore të rritjes së dënimeve dhe masave sanksionuese për dhunuesit, kur gjenden argumente se diçka e tillë ka ndodhur në një rast dhunimi.

## DUKURIA E ZHUKJES SË VAJZAVE DHE GRAVE

Rrallë ndonjë ditë nuk evidencohet në tabloidet informative kosovare zhdukja e vajzave dhe grave.

Sepse, zhdukja e femrave në Kosovë, pothuajse, është e përditshme...

Por, rrallëherë herë ka informacione se kur të zhdukurat janë kthyer në shtëpi dhe ku kanë qëndruar gjatë kohës jashtë shtëpisë...

Shteti me organet e veta duhet jo vetëm të jetë bartës statistikor, por përgjegjës i hulumtimit në detaje të zhdukjes së femrave, duke ardhur në përfundim se a është zhdukje, braktisje apo argëtim?

E, që të vihen gjërat nën kontroll, shteti duhet të ketë më shumë kontroll në diskoteka, në organizime e ahengje të ndryshme: Kush i organizon ato dhe cili është qëllimi real i tyre?

Sidoqoftë, zhdukja e femrave është njollë e zezë edhe para bashkësisë ndërkombëtare, e që shqiptarët dhe Kosova, si vend me tradita vlerash të larta morale, gati prinë në listat e deformiteteve shoqërore.

# Kurrë s'ka me u bë mirë!

Një mori njerëzish, kryesisht pensionist, çdo mëngjes ia mësyjnë Gërmisë, që në orët e para të mëngjesit. Madje, edhe gjatë dimrit, kur bënë ftohtë e acar.

Dhe, sikur bëjnë garë se cili do shkojë më herët, kur, pa dyshim, kah mesdita është koha më e mirë për të ecur, për të shëtitur, meqë në mesditë temperatura e ditës është paksa më e lartë.

E, kah ora 9 e mëngjesit, teksa kthehen nga Gërmia, i takoj te Pishina e Gërmisë, vend ku parkohen autobusët e linjës 4, që qarkullojnë për në qytet.

Por, qëllimi i këtij shkrimi është të paraqes një episod të shkurtër me një pak më të moshuar se unë, i cili, posa hipi në autobus, m'u drejtua me fjalët: "A u lodhe?" "Jo", ia ktheva dhe vazhdova: "Nuk

kam qenë në Gërmi. Banoj këtu afër, në Sofali".

"Lëre Sofalinë, por nga je?", më tha. "Jam i rrethinës së Ferizajt", i thashë.

"Sali Bajrami kishte pas lindur në Ferizaj. Por, familja e tij kishte pas kaluar të jetojë në Drenicë.

E, kur e pyesnin nga ishte, u thoshte: "Jam nga Ferizaj, por jetoj në Drenicë".

(Me siguri, nuk e pat fjalën për rap-sodin Sali Bajrami, sepse ai është i lindur në Llashka Drenoc të Malishevës, por për ndonjë Sali Bajram tjetër, që nuk arrita ta kuptoj).

Dhe, nisi të flasë, pastaj, për përditshmërinë politike, kuptohet nga këndi i tij...

Por, për ta përmbyllur muhabetin, më lindi ideja t'i them "Mirë e bën Zoti!", duke menduar se me

këto fjalë edhe do i japim fund muhabetit që sa vinte e bëhej më i rëndë.

E, për çudi, më ktheu: "Jo, kurrë mirë s'ka me u bë! Ama bash kurrë!".

Dhe, plasi gazi...

Ndërkaq, episodi tjetër ka të bëjë me një të moshuar tjetër, një ditë tjetër, i cili, teksa hipi në autobus, nga telefoni dëgjonte një këngë folklorike.

Zëri ishte jo i lartë, por kënga ishte thuajse pa lidhje...

Më tha: "A po të pengon muzika?"

"Jo", i thashë.

"Nëse të pengon, e ndali menjëherë!", ma ktheu.

E, pse ta ndalte, kur zërin e kishte aq të ultë, sa, me siguri, as vetë s'ia dëgjonte tekstin...

Isa ILAZI



# PSE NUK IA DIMË ZOTIT SHYQYRIN?!



\*

Përvoja e jetës lë shumëçka. Lë edhe mendime, thënie të vlefshme, të dobishme për çdo kohë, për çdo kë.

Mbesin dhe fitojnë emër - fjalë të popullit, fjalë të plakut, fjalë të urta, shprehje filozofike etj., të cilat ne tash i lexojmë e na pëlqejnë.

Na pëlqejnë, ngase disa prej tyre i përfetojmë edhe vetë.

Edhe këto, të poshtëshënuarat, janë nga jeta:

Thonë, nëse ke ushqim, rroba për të veshur dhe një kulm mbi kokë, je më i pasur se 75 për qind të njerëzve të botës.

Nëse ke para, bën pjesë në 8 për qind të të pasurve të botës.

Nëse je zgjuar në këtë mëngjes pa sëmundje, je më i bekuar se miliona njerëz anë e mbanë botës që nuk do ta mbijetojnë këtë javë.

Nëse nuk ke përjetuar asnjëherë burg, tortura apo kërcime, je më fatlumi se 500 milionë vetë të gjallë, e që vuajnë.

Nëse mund ta lexosh këtë, je më fatlum se 3 miliardë njerëz që nuk dinë shkrim-lexim...

\*

Pse i mbyllim sytë kur lutemi, kur ëndërrojmë, kur qajmë, kur na dhembë diku, kur puthemi?

Gjërat më të bukura, por edhe më të dhembshmet në jetë, nuk shihen përmes syve, ato ndihen përmes zemrës, shpirtit.

Edhe njerëzit janë si hëna, e kanë një anë të cilën nuk ia tregojnë kurrë askujt... e kanë të fshehur, e të cilën e dinë, e njohin vetëm vetë...

Çdo kush mund t'u bëjë të lumtur kur bën diçka të veçantë, por edhe vetëm dikush i veçantë mund t'u bëjë të lumtur pa bërë asgjë.

Sot bëhu arsyeja e dikujt për ta bërë që të buzëqeshë... krijoja, falja një çast që të ndjehet i lumtur a e lumtur...

Femrat janë gënjeshtare. Të thonë "të urrejë", a të duan me shpirt!

Meshkujt janë mashtrues, të thonë: "Jam mirë, kurrë më mirë", a në shpirt kanë prush, vullkan!

## E THOTË JETA...

Paraja nuk është gjithçka.

Ajo mund ta blejë shtratin, por jo gjumin.

Mund ta blejë orën, por jo kohën.

Mund ta blejë librin, por jo dijen.

Mund ta blejë pozitën, por jo respektin.

Mund ta blejë ilaçin, por jo shëndetin.

Mund ta blejë gjakun, por jo jetën...

**Gani Dili**

# KOSOVARJA

magazinë e pavarur  
për familje

[www.kosovarja.al](http://www.kosovarja.al)

**Pronar dhe botues:**

Gani DILLI

**Redaktor përgjegjës:**

Isa ILAZI

**Menaxher:**

Driton DILLI

**Redaksia:**

Safet Krivaça (reporter i lirë)

Nderim Neziri (redaktor)

Besiana Dili

Drenushë Haredinaj

Ardita Dili

Edona Vllasaliu - Bajoku

Xheneta Spahiu

**Dizajni:**

Labinot Bërbatovci

**Adresa e redaksisë:**

Fahu postal 18, 10000 Prishtinë

Tel: 038 51 75 75

Email: [info@kosovarja-ks.com](mailto:info@kosovarja-ks.com)

**Marketing:**

Tel: +383 44 143 448;

Email: [marketing@kosovarja-ks.com](mailto:marketing@kosovarja-ks.com)



Amerikanët nuk harrojnë...

# CIA nuk e harroi 50 vjet agjentin e vet, Rexhë Berishën e Pejës

*Rexhë Hysën Berisha, nga Novosella e Pejës, në Gjermani kishte punuar me një grup oficerësh amerikanë të CIA-s, për zbarkim në Shqipëri e përmbysje të Enver Hoxhës...*

## HISTORIATI I REXHË BERISHËS

U lind në Novosellë të Pejës, në vitin 1918. Më 1943 inkuadrohet në Batalionin për diversantë "SS Skënderbeu", ku edhe luftoi në shumë arena luftimesh kundër forcave çetnike në Mal të Zi: Plavë, Guci, Beranë, e në vende të tjera.

Me shpresën se do të bashkoheshin trojet shqiptare, e veçmas Kosova me Shqipërinë, ai në fillim të karrierës atdhetare punoi në gardën e xhandarmërisë, duke bashkëpunuar me Italinë dhe Gjermaninë.

Një vit më vonë iu bashkua grupit prej 13 vetash, kryesisht të Ballit Kombëtar nga fshati Novosellë dhe u ngjiti në malet e Radavciit, duke u pozicionuar në shpellën mbi burimin e Drinit të Bardhë, e njohur si "Shpella e Bezdanit".

Në atë shpellë, grupi, me mbështetjen e popullit, qëndroi një vit heroikisht.

Në vitin 1945, pas një beteje me organet e shtetit, grupi i tij, prej 50 luftëtarësh, mori rrugën për në Greqi.

Dhe, as shumë sfidave, Rexhë Berisha arriti në Greqi dhe prej aty në Itali, e më vonë depërtoi në Gjermani.

Me arritjen në Gjermani, Rexhë Berisha u fut në strategjinë për çlirimin e Shqipërisë nga regjimi diktatorial komunist i Enver Hoxhës, përcaktim që arriti Shërbimi Sekret Britanik "M16", që ishte, kryesisht, shërbim që dominohej nga Shërbimi Inteligjent Amerikan - CIA.

## REXHË BERISHA USHTROHET PËR DIVERSANT

Duke treguar për shkathhtësitë fizike të babait të vet në fazën e trajnimit për luftim në male, i biri i tij, Samiu, në dhjetor të vitit 2014, kur edhe e vizituam në shtëpinë e tij, thotë:

"Babai ishte pjesë e një programi të veçantë amerikano-britanik për luftime në male, gjë që i përshtatej futjes së tij në Shqipëri, ku edhe duhej të gjente mbështetës për rrëzimin e regjimit komunist të Enver Hoxhës.

Grupi diversant përbëhej nga katër vetë: Rexhë Berisha, Halil Nerguti, Miftar Maloku dhe Ramadan Zejna, nga Kukësi.

Desanti i grupit është kryer në mesin e muajit nëntor të vitit 1949.

Shërbimi inteligjent shqiptar ndihmohej nga rusët dhe kjo kishte bërë që diversantët e mëparshëm të kapeshin në Shqipëri.

Por, grupi i Rexhë Berishës kishte shpëtuar falë gabimit të pilotit, i cili i kishte lëshuar gabimisht me parashutë, në vendin jo të

duhur.

Kishin zbarkuar në malet mbi Tropojë. Dhe, ai gabim i pilotit kishte dalë të jetë dhuratë që pjesëtarët e atij grupi të shpëtonin gjallë...

Për dy vjet rresht, prej vitit 1949 e deri më 1951, grupi i Rexhë Berishës kishte bërë përpjekje t'i koordinonte punët me shqiptarë të Malësisë së Hasit, por nuk arrinë të gjejnë ithtarë për bashkëpunim, ani pse Malësia e Tropojës njihej si vend antikomunist.

Andaj, pas dy vjetësh, ishin drejtuar në drejtim të Kosovës...

Në Prizren, me sugjerimin e një qytetari, kishin shkuar në Çaçak të Serbisë, ku edhe qëndrojnë një vit, kinse si shtetas të Shqipërisë.

Por, pas një kohe kthehet në Novosellë dhe fillon të bëjë jetë, duke siguruar bukën nga puna në bujqësi.

Një periudhë të jetës së vet e kaloi në varfëri.

Ai e përjetoi edhe luftën e vitit 1999".

## AMERIKANËT NUK E HARRUAN AGJENTIN E TYRE...

Por, amerikanët ishin ata që nuk e harruan. Paslufte i erdhën në vizitë një grup zyrtarësh shtetëror të SHBA-së, duke i dhënë dekoratën e CIA-s, por edhe 35 mijë dollarë, e që i shfrytëzoi për rindërtimin e shtëpisë së djegur në luftë.

Vdiq më 22 shtator 2014, në vendlindje, në Novosellë të Pejës.

S. Krivaça



*Mr. Dapper është brendi i këpucëve luksoze, i cili në trojet shqiptare u bë i njohur përmes një emri, Albert Gjukajt, njeriut të rrallë që ia del suksesshëm të krijojë këpucë unike, luksoze dhe të jashtëzakonshme në dizajn dhe cilësi.*

*Albert Gjukaj është artist në zanatin e tij, meqë krijon përtej fantazisë e imagjinatës së zakonshme.*

*E, kush është realisht ky njeri, me pasion e përkushtim kaq të rrallë për këpucët? Cila është historia dhe tregimi i tij?*

# Shqiptari Albert Gjukaj,

xhentëlmeni maestro  
i këpucëve luksoze



### **Nëse kthehemi në të kaluarën tuaj, çfarë duhet të dimë?**

- Jam Albert Gjukaj, nga Strellci i Deçanit, por me vendbanim në Cyrih të Zvicrës. Këtu jetoj qe 30 vjet me familje.

Aktivitetin tim e zhvilloj në Luzern. Jam bashkëpronar i kompanisë Mr. Dapper në Luzern.

### **Ndonjë moment që e ka shënuar fëmijërinë e rininë tënde të hershme?**

- Shkaku i disa përjetimeve në rini, kam pasur më pak vetëbesim gjatë fazës së hershme të fëmijërisë. Mirëpo, kur bleva këpucët dhe kostumin tim të parë, e vërejtja që më ndihmonte të ndihem më mirë dhe të kem më shumë guxim në ndjekjen e ëndrrave të mia të vërteta.

Dhe, më duhet të them se që nga fëmijëria më befasojnë produkte me detaje specifike.

E, merakli ishte edhe gjyshi im, i cili e mbante veshjen si zotëri nga mëngjesi deri në mbrëmje, kudo që ishte.

### **A ishte qëllimi yt në jetë të bëheshe ky që je sot?**

- Patjetër, po. E, këtë dua ta dëshmoj edhe në kampionatin botëror për këpucë dhe këpucëtarë që mbahet sivjet në Londër.

### **Ku e ka zanafillën pasioni yt për këpucët?**

- Si i vogël më pëlqenin njerëzit që visheshin me kostume dhe këpucë të bukura.

Gjatë fëmijërisë sime, në vitet 80, ndikoheshim shumë edhe nga filmat dhe stili i veshjes njujorkeze të asaj kohe, stil të cilin vendosa ta veçoj dhe ta shndërroj edhe në profesionin tim.

Pra, mund të them se pasioni im për këpucët nisi qysh moti në jetën time.

### **A mendoje se ky zanaat e kjo punë mund të ketë të ardhme?**

- Unë, personalisht, mendoj se njerëzit tani kanë më shumë kujdes dhe informata për shëndetin e tyre.

E, duke qenë se këpucët janë një ndër aksesoret më të rëndësishëm, patjetër, kishte interesim për kualitet dhe cilësi të lartë të materialit.

"Fast fashion" ishte një industri

në rënie dhe, kështu, vendosa t'i përkushtohem pasionit të ëndrrës sime që nga fëmijëria.

Pastaj, siç dihet, me punë, përkushtim e pasion sukseset vijnë vetvetiu...

Ne bashkëpunojmë me biznese familjare me traditë të gjatë, të cilët diturinë e tyre mbi 200-vjeçare e kanë trashëguar në këtë industri nga Londra, Milano dhe Parisi.

### **Nga këpucëtar, në maestro këpucësh luksoze. Cila ishte rruga nga fillimi deri këtu?**

- Rruga për të arritur te ajo që dëshirojmë shumë rrallë është e lehtë. Ëndrra ime ishte gjithmonë që ta kem butikun tim për xhentëlmën në Zvicër, që ta kujtojmë Nju-Jorkun e viteve 80.

E, me punë e dashuri ndaj profesionit tim, kam arritur që t'i bind edhe disa investitorë, njerëz shumë të suksesshëm në profesionet e tyre, që ta hapim butikun dhe t'i ofrojmë shërbimet tona për klientët.

### **A kishte sfida, vështirësi dhe nëse po si ia dole?**

- Po, sfida ka gjithmonë dhe rruga nuk ishte aspak e lehtë.

Në fakt, sfida dhe vështirësi kemi akoma, meqë nuk kam arritur ende atë që e kam dashur gjithmonë, pra titullin e kampionit në punën që bëj.

### **Sot, njiheni si Mr. Dapper. Na fol më shumë për biznesin tënd dhe atë se çfarë bën e çfarë ofron?**

- Mr. Dapper është një biznes aksionarë me butikun në Luzern dhe butikun online.

Merremi me shitjen, riparimin dhe dizajnimin e këpucëve me porosi për klient individual, e, po ashtu, na vizitojnë në butik edhe njerëz nga gjithë bota.

Në asortimentin tonë kemi edhe çanta, jakne e aksesore nga lëkura të ndryshme, të cilësisë së lartë për xhentëlmën.

Njerëzit e dinë tashmë se produktet tona janë të veçanta dhe porositë janë individuale, pra me masa të veçanta për secilin klient. Këpucët tona ofrojnë një vezullimë dhe qëndrueshmëri të gjatë, e, gjithashtu, janë të shëndetshme dhe të rehatshme për këmbët e tyre.



### **Me çfarë lëkurash punon?**

- Lëkurat që përdoren për krijimin e këpucëve tona janë të ndryshme. Kemi mbi 80 prej tyre.

Zakonisht, përdoret lëkura e viçit për modele standarde, ndërkaq lëkura e preferuar imja është ajo e aligatorit.

Dua të theksoj se lëkurat, e edhe materialet që ne i përdorim, janë të certifikuar nga "CITES", e cila garanton mbrojtjen maksimale të kafshëve dhe kualitetin e produkteve.

Me këtë certifikatë ne eksportojmë produktet tona në tërë botën...

### **A punoni me porosi dhe a ka ndonjë personalitet të njohur për të cilin keni punuar këpucë?**

- Burimi ynë kryesor i punës vjen nga porositet individuale dhe, siç dihet, xhentëlmenët janë njerëz që duan ta ruajnë privatësinë e tyre.

Andaj, për këtë arsye, i publikojmë në rrjete sociale vetëm ata klientë që duan t'i ekspozojnë këpucët tona.

### **Këpucët më të shtrenjta në Mr. Dapper?**

- Këpucët më të shtrenjta që kemi krijuar deri tash janë për një klient privat dhe kapin vlerën mbi 20 mijë euro.

Por, gjithçka varet nga kërkesat e klientëve. Në butik kemi edhe këpucë që fillojnë nga 290 franga dhe aksesorë të ndryshëm me vlera më të lira.

### **A punoni edhe seri, apo vetëm me porosi?**

- Kemi modele serike të prodhuara në Evropë, por zakonisht punojmë me porosi me përmasa individuale.

### **A ka shqiptarë që blejnë?**

- Ka, madje shumë. Janë sportistët ata që kujdesen për shëndetin e këmbëve të tyre më shumë se të tjerët, politikanët për paraqitje sa më imponante dhe biznesmenët e suksesshëm që shijojnë suksesin e tyre.

### **Kujt nga personalitetet botërore ose shqiptare do ia bëje një parë këpucë? Kush do doje t'i mbathte këpucët e Mr. Dapper?**

- Xhems Belushi është personazhi për të cilin do ia punoja me shumë dëshirë një parë këpuce unike.

### **Ti, a bën jetë luksi?**

- Mund të them se puna ime sot më lidhë me jetën e luksit dhe më duhet të udhëtoj anembanë botës.

Mirëpo, unë jetoj si një familjar i thjeshtë dhe gjithmonë në radhë të parë është familja.



Sidoqoftë, jam i pasionuar pas produkteve dhe veshjeve me cilësi të lartë. Kryesisht punojmë dhe shërbejmë njerëz që bëjnë jetë luksoze.

### **Diçka përtej zanatit, punës, biznesit?**

- Jam i martuar dhe i kam tre fëmijë.

Kohën e lirë, zakonisht, mundohem t'ia kushtoj familjes, edhe pse është shumë e pakët.

Më pëlqen të marrë pjesë në evenimente të ndryshme VIP-ash ose sfilata të modës së lartë, ku, zakonisht, jam i ftuar nga partnerët dhe kolegët e punës.

### **Hobet, dëshirat, ambiciet?**

- Hector: Highend fashion është pasioni im.

Ambicia ime është të arrij piedestalet në kampionatin ndërkombëtar për këpucëtarë në Londër, sukses me të cilin do i gëzoja familjen dhe krejt stafin e Mr. Dapper.

Dëshira ime është t'i përfaqësoj gjithë shqiptarët në mënyrë sa më dinjitoze dhe të kthehem me fitore.

### **Mesazhi yt?**

- Misioni im është me promovuar që këpuca mund të ndryshojë shumë gjëra në jetë dhe t'u tregoj njerëzve se si bëhet kjo. Misioni im është promovimi i faktit se këpuca mund të ndryshojë shumë gjëra në jetë.

Mesazhi që dua të përcjell është se secili duhet t'i ndjekë ëndrrat e tij dhe të punojë pa hezitim.

Jam i hapur për të gjitha temat rreth këpucëve, andaj mund t'më kontaktoni me pyetje dhe ide të ndryshme rreth kombinimeve sipas stilit "Gentelman".


### **Të faleminderit për intervistë!**

- Faleminderit juve!

**Nderim Neziri**



# Kosova duhet të krenohet me kolosin e kinematografisë, Besim Sahatçiu



*Shumë vite më parë, atëherë kur njeriu te ne fshihej edhe nga vetja, ashtu si vjedhurazi, pata parë në një stacion televiziv jugosllav një film që më tronditi me titull “Era dhe lisi”.*

Më tronditi dhe më la mbresa të pashlyera. Quhej “Era dhe lisi” dhe fliste me vërtetësi rrëqethëse dhe një guxim të pabesuar për fatin e shqiptarëve atje...

Veç kësaj, ishte dhe loja e mahnitshme e aktorëve, sidomos atij kryesorit, Abdurrahman Shalës, portretin dhe karakterin artistik të të cilit do ta kishin zili edhe ata në Holivud.

Po, asnjëherë nuk e mësova se cila qe ajo dorë që i kishte përzgjedhur ata aktorë virtuozë dhe ajo mendje që e kishte realizuar këtë film, që jo vetëm i bënte nder Kosovës, por edhe tregonte se ç’forcë krijuese kishin intelektualët e saj, pa haruar të përbotshmin Bekim Fehmiun.

## REGJISORI ENIGMATIK

Por, ja si është jeta: miku im i shtrenjtë, akademiku Kopi Kycyku, ai i dituri, energjiku dhe prodhimtari i rrallë, ma shuaji kureshtjen, duke më dhuruar librin – album të tij “Besim Sahatçiu - një jetë për ekranin dhe skenën”.

Këtu zbulova regjisorin enigmatik, të atij filmit mbresëlënës, por dhe gjeta një figurë poliedrike, që gjithë talentin dhe aftësitë e tij profesionale i vuri në shërbim të vendit të tij fatkeq.

Dhe, përherë kam menduar se pas luftës çlirimtare në Kosovë, e cila kushtoi jetën e mijëra e mijëra njerëzve të pafajshëm, të paktën, shkëmbimet kulturore, pra ato shpirtërore mes dy vendeve të ndara

poshtërsisht, do intensifikoheshin.

Por, kurrë nuk e kuptova apatinë zyrtare, për të dhënë e marrë në këtë drejtim, pra për ta mbajtur të ndezur zjarrin e njohjes dhe dashurisë mes vëllezërve dhe motrave të të njëjtit gjak, të të njëjtës histori dhe të të njëjtit fat!

Përkundrazi, duke njohur më mirë njëritjetrin, ne do të bëhemi edhe më të mençur.

## PSE BESIMIN E QUAJNË KORIFE?

Kopi, me të drejtë, e quan Besimin korife. Po, i tillë del ai në këtë jetëshkrim, të një lloji krejt të ri.

I bukur në të parë, i ëmbël, i urtë, i mbushur me vullnet, përherë i menduar dhe me një shikim të tretur larg e plot dritë, ai kuptohet lehtësisht, se ka vetëm një preokupim: si të arrijmë më të mirën. Dhe, jo vetëm kaq; por si ta ngrejë nivelin atje ku nuk e ka çuar kush, atje ku me përparimet e sotme ka mbërritur arti skenik evropian...

Duhet pranuar se Besim Sahatçiu, krahas të qenit njeri i veprimit, pra një organizator mjaft i aftë, për të përgatitur një pjesë për teatër apo film, ishte, në radhë të parë, një njohës i thellë i të fshehtave të këtij arti. Pra, ai ishte një teoricien, në kuptimin e plotë të fjalës.

Besimi i provoi të dy ekranet dhe skenën e teatrit me sukses, brenda atyre mundësive

që kishte Kosova. Madje, ai edhe guxoi t’i maste forcat me dinjitet, nëpër 35 festivale të ndryshme me të huajt, si në Itali, Portugali, Spanjë, Poloni, Turqi, Siri, Kroaci, Tiranë, etj.

Mësimet e Akademisë së Arteve në Zagreb, studentit nga Peja, i kishin vlejtur shumë, por ai nuk iu nda asnjëherë studimit, çka e dëshmon dhe biblioteka e tij e pasur.

## Ç’OBLIGIM KEMI NDAJ BESIM SAHATÇIUT?

Kosova, pa tjetër, do të krenohet gjatë me një artist si ai, i cili, me atë që realizoi, i bashkëngjitet pa asnjë mëdyshje kolosëve të kinematografisë dhe teatrit shqiptar dhe që i dha përgjigjen e merituar shpifjeve dhe fyerjeve të shovenëve, si Miodrag Bullatoviçit te libri i tij “Njerëzit me katër gishta”.

Kurse ne, në Shqipëri, e kemi për detyrë ta kujtojmë këtë njeri, duke shfaqur filmat e tij “Tre vetë kapërcejnë malin”, “Pasqyra”, “Përroi vërshues”, “Pehlivanët”, “Bukë, kripë e zemër”, “117”, që e kanë quajtur “portret shpirtëror të popullit tonë” dhe sidomos “Era dhe Lisi”, që më kishte mbetur aq gjatë në mendje dhe nuk dija asgjë për regjisorin e saj, e që tani ma tregoi kaq thjesht dhe madhërishtëm, njëkohësisht, miku ynë i mirë, Kopi Kycyku.

**Shpendi Topollaj**





★★★★★  
**BREZOVICA**  
HOTEL & SPA



E Shtunë 28.10.2023  
Fillon nga 19:00 deri më 22:00

# HALLOWEEN

JU SHIJONI MUZIKËN LIVE  
NE KUJDESEMI PËR FËMIJËT TUAJ

**Pjesmarrja në festë për fëmijë është FALAS!**

PROGRAMI: MUZIKË DHE ARGËTIM PËR FËMIJË, PIKTURIM FYTYRE, LOJËRA DHE GARA  
MENU: LËNGJE, MINI SANDUIÇE, MINI BURGER, NUGGETS PULE, PICA, ËMBËLSIRA DHE SNACKS

Të veçantit...

# Personalitetet *me gratë mise*

## GJENERAL LEJTNANT AGIM ÇEKU DHE MISI MIMOZA HARXHI

Gjeneral Agim Çeku ka qenë komandant i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, komandantit i TMK-së dhe kryeministër i Republikës së Kosovës. Ishte një nga politikanët më serioz në skenën politike vendore, i cili njihet si person i prerë dhe pa shumë fjalë. E, në jetën private është në lidhje shumëvjeçare me "Miss Kosova 2000", bukuroshen pejane Mimoza Harxhi, me të cilën ka edhe fëmijë.



## PUBLICISTI E POLITIKANI VETON SURROI DHE MISI BLERTA SYLA

Veton Surroi vjen nga një familje e njohur shqiptare. Babai i tij, Rexhai Surroi, ishte ambasador. Si rrjedhojë, Vetoni e kaloi një pjesë të jetës së tij në botën spanjisht-folëse dhe u shkollua atje.

I flet disa gjuhë.

Në vitin 1977 themeloi gazetën e përditshme më të lexuar në Kosovë, "Koha Ditore" dhe për disa vite punoi kryeredaktor në të.

Më vonë, i pakënaqur me elitën politike në Kosovë, futet në skenën politike, duke themeluar Listën Qytetare "ORA", të cilën më pas e shndërroi në parti politike.

Në zgjedhjet e përgjithshme në Kosovë, të mbajtura në vjeshtën e vitit 2004, fitoi vendin e deputetit në Kuvendin e Kosovës.

Ish-lideri i Partisë "ORA" është i martuar me aktoren Blerta Sylën, e cila njihet si aktore shumë e njohur në vitet 90, por edhe me disa role filmike në kinematografinë kosovare. Ajo njihet edhe si bukuroshe, e cila në vitin 1995 e fitoi kurorën e bukurisë dhe u shpall "Miss Kosova 1995".







What's next...

# LAST CALL OF SUMMER

pay 3 nights stay 4

Book now  
+355696041000  
[www.marinabay.al](http://www.marinabay.al)







# Si e gjeta tim bir pas 12 vjetësh?

*Kush do të besonte se do ta takoja tim bir pas 12 vjetësh në stacionin e tramvajit S-15, në Hanover të Gjermanisë, e do të qanim të dy, duke u shikuar në sy?!*

Ishte shtatë muajsh im bir kur ndodhi lufta në Kosovë.

Burri im pat ikur jashtë vendit para lufte. Kërkonte grua për t'i bërë letrat atje, pa qarë kokën se ne kishim

mbetur këtu, në zjarr, duke bredhur mal më mal, në kërkim të shpëtimit të shpirtit.

Nuk e kisha shumë dert për vete, sa për djalin e vogël. I mendoja storjet televizive të luftës në Drenicë dhe mendoja tim bir...

Teksa i mendoja ato gjëra, u rrëzova duke zënë në thua në rrënjën e një lisi dhe mezi shpëtova pa pasoja. Aty një grua plakë ma mori djalin nga krahu. Më tha se do më ndihmonte aq sa mundet, ashtu që unë të pushoja pak. Aso kohe nuk dija se ku ishte ti, babai i djalit tim të vogël, që sapo kishte filluar t'i shqiptonte fjalët e para?!

Tre muaj të luftës i kalova kodër më kodër, vazhdimisht në kohë me shi. Djali ishte i vogël dhe nuk dinte çka

po ndodhte. Ai nuk dinte se ishte i kërcënuar të vdiste nga hasmi dhe mirë që nuk e dinte.

Ai nuk dinte se nga çasti në çast na rezikohej jeta.

E, lindja e diellit na gjente nën shkurre dhe lisa të malit...

## SI DHE PSE U KTHYE BURRI IM PAS LUFTE?

U kthye burri pas lufte dhe unë mendoja se është kthyer të jetojë me ne, por kishte qenë e kundërta.

Për ta arsyetuar martesën e vet më akuzoi se kisha bërë amoralitet në male gjatë luftës dhe ma mori djalin nga duart. Ishte akuzë e rëndë për mua, sepse s'kishte të bënte asgjë me realitetin,

duke ikur mal më mal gjatë luftës.  
"Oh, Zot! Ku u gjet lufta mu në kohën kur rriteshe ti, në duart e mia, biri im?!", këto fjalë m'u sollën në mendje atë kohë.

E, fjalët e burrit më shumë kishin qenë provokuese, shkas që t'ma merr fëmijën nga duart...

Dhe, nga ajo ditë unë mbeta e vetmuar, me vuajtje në shpirt, në zemër. Në anën tjetër, kisha shumë ngarkesë në shpirt, sepse më ishin lëshuar në kokë edhe familja ime, duke më thënë të martohem apo të më martojnë me zor.

E, ata bëheshin sikur nuk e dinë se unë e kisha një djalë diku, në botë, me të cilin doja të takohesha e të jetoja në një kohë që do vinte.

E, ai, me siguri, do ketë mësuar nga një dikush se diku e ka një nënë që e ka lindur, se ajo e ka bartur mal më mal për t'ia shpëtuar jetën.

## MË I MIRË BURRI I DYTË SE I PARI...

Pas një kohe familja më gjeti një burrë.

Më thanë se nuk mund të jetoja kështu, vetëm, sepse duhej të bëja jetë në bashkëshortësi dhe të krijoja familje te re.

Ata nuk e kishin keq, sepse nuk i kisha armiq, por unë mendoja se ato ditë që do të martohesha do e humbja tim bir dhe më nuk do të jem nëna e tij.

Më nxorën të takohesha me burrin tim të ardhshëm, i cili jetonte në Perëndim dhe më këshilluan të mos flisja për djalin tim.

Ditën që u pamë i thashë se e kam një djalë dhe se herë do kur, nëse takohem me të, do të insistoj ta marrë.

Ai, pasi më dëgjoi me kujdes, më tha se gjithmonë do e kem mirëkuptimin e tij, e kjo më bëri shumë përshtypje, sa mezi prita të martohem me të.

Dhe, pak muaj më vonë, m'i bëri letrat dhe më mori me vete, ku edhe jetonte.

E, atje, diku, jetonte edhe im bir...

Ndjeja se do ta takoja një ditë, pasi Zoti na shpëtoi të dyve në ditët më të rënda të jetës, në kohën e luftës...

## KUSH MA SHOI MALLIN PËR DJALIN?

Një ditë, teksa prisja tramvajin, një djalë rreth 12-13 vjeç, vinte drejt meje.

E shikova në sy. Më pëlqyen sytë e tij...

"Morgen (mirëmëngjesi)", i thashë.

"Morgen!", ma ktheu.

Dhe, pranë njëri-tjetrit qëndruam gjatë kohë, derisa erdhi tramvaji dhe hipëm në të.

Në tramvaj e shikoja me habi, sepse në të e shihja tim bir...

Në ato çaste m'u kujtua lufta dhe më rrodhën lotët. M'u kujtuan çastet kur tim bir e bartja mal më mal që t'ia shpëtoja jetën...

## TAKIMI ME DJALOSHIN QË E MENDOJA SI IM BIR

Të nesërmen kuptova pak më shumë për të, kur e pashë teksa e priste tramvajin e njëjtë.

Ishte me të njëjtën çantë dhe me të njëjtat roba.

I dhashë një përsëndetje.

E, edhe ai më përsëndeti.

Ndërkohë, nxori telefonin nga çanta dhe iu përgjigj një thirrjeje. E dëgjova teksa fliste shqip.

"Çun, di shqip, a?!", i thashë posa e ndërpreu bisedën.

"Po, jam shqiptar, i lindur në Kosovë", ma ktheu.

"Me kë jeton?"

"Jetoj me babanë tim dhe gruan e tij

gjermane".

Dhe, në ato çaste m'u duk se më ra qielli mbi kokë.

Ndërkohë, erdhi tramvaji dhe ai hipi e unë, e tretur në mendime, mbeta në stacion.

Andaj, mezi e prita të nesërmen ta shihja përsëri. Nuk më mori gjumi tërë natën...

Por, për çudi, kaluan shumë ditë e më nuk e pashë...

Dhe, kur krijova bindjen se më nuk do e takoja kurrë, e pashë në stacion.

Kisha një arsye më shumë që ta pyesja se ku ishte ato ditë që mungonte...

"Kemi qenë në ekskursion", ma ktheu ai.

"Si e pate emrin?", i thashë.

"Erma!", më tha.

"A e ka babai yt emrin Ruhan?", i thashë.

"Nga e di emrin e babait tim?!", më tha.

"E di, sepse ti je im bir. E, unë jam nëna jote!"

Ishe i vogël kur je larguar nga unë dhe nuk i di gjërat si kanë rrjedhur...", i thashë me sytë mbushur lot.

Dhe, në ato çaste se ç'mu sollën në mendje gjithë ato ikje maleve me tim bir në krahë, nga kodra në kodër, teksa iknim për ta shpëtuar shpirtin...

**S. Murturi**

Radio,  
Lajme, Moti,  
Video, TV, ...

Vetëm me aplikacionin  
**Shkabaj** për Android

ANDROID APP ON  
**Google play**

KOSOVARIA | 17

# Të flasësh shqip është më shumë se nder!



*Nëse në një periudhë të gjatë kohore gjuha amtare nuk përdoret shpesh, atëherë ajo bëhet më e dobët.*

Në kërkimet shkencore kjo quhet "Attrition", ku ne, papritmas, bëjmë gabime gramatikore ose e kemi të vështirë t'i gjejmë fjalët adekuate, të cilat duam t'i artikulojmë gjatë komunikimit.

Kjo më është shpjeguar para disa ditësh nga një profesor, në një kurs retorik, për të cilin kurs kam paguar një shumë të majme me 4 shifra dhe këtë, pikërisht, për të "mësuar" si të artikulojen fjalët në gjuhën amtare shqipe, gjuhën e origjinës, e që qenka 6000 vjet e vjetër.

## PSE KY KURS?

Sepse, sipas shumë "ekspertëve" autoktonë, unë, me dialektin e Dukagjinit, nuk i përshtatem tregut! Dhe, tani, pas këtij fakti për gjuhën tonë të bekuar, kokulur pyes veten "Cilit treg?".

Tregu që, pos gjuhës, ka filluar të na e modernizoj edhe dinjitetin dhe vlerat tona njerëzore dhe kombëtare.

E, kjo është e dhimbshme, sepse tregon se ne, si shoqëri, përfshirë në radhë të parë veten time, përpos mohimit të shumë vlerave që kemi si popull, mohojmë edhe gjuhën tonë, që e kemi mësuar nga gjyshet e gjyshërit, nënat dhe baballarët tanë, nuk vlerësojmë sa duhet atë që kemi dhe kërkojmë përsosmëri ose, më mirë të themi, konfirmim nga të tjerët, përkatësisht nga të huajt, se, në të vërtetë, ne jemi populli që flasim gjuhën më të vjetër.

Dhe, nuk besoj se këtë nuk e kanë vërtetuar më parë gjuhëtarët dhe historianët tanë...

Ne kemi krijuar aq shumë mekanizma mbrojtës në psikologjinë tonë, saqë, siç duket, si shumë herë gjatë historisë, duhet të huajt të na tërheqin nga pasqyra që, ne, me egon tonë, i jemi afruar aq afër, duke e parë vetëm turbullira, për të mos e dalluar dot madhësinë tonë si popull!

Sidoqoftë, nuk dua të zgjerohem këtu, sepse nuk jam historiane...

Unë, nga dashuria për ndjenjën e përkatësisë, e që vuajmë të gjithë ne, mërgimtarët, fillova të luhatem në mendimin tim se është, pikërisht,



gjuha amtare thelbi simbolik i mendimit që shprehet me fjalë.

## E MOHON ORIGJINËN - E MOHON VETVETEN!

Kursin e ndërpreva menjëherë, duke marrë si leksion se kur mohon origjinën - mohon vetveten.

Secili nga ne i ka vlerat dhe qëllimet e veta në jetë, që ndonjëherë, mbase, nuk përshtatën me shumë komponent tjerë objektivë apo kohorë, mirëpo është guximi ynë që bën dallimin kur zgjedhim se dëshiron t'i përshtatesh tregut apo të dëgjosh zërin tënd të brendshëm.

Këtu, pastaj, kërkohet qartësi dhe dashuri ndaj vetes dhe pasionit tënd shpirtëror, pasi nuk besoj në rastësi, sepse të jesh shqiptar në diasporë nuk është vetëm identitet, por është edhe më shumë se ky.

Është diaspora që duhet të ndjehet krenare dhe të vazhdojë misionin që ndër breza ka ruajtur gjuhën shqipe. Assesi mos të turpërohemi për dialektet tona.

Por, të apelojmë te rinia dhe prindërit e rinj se të flasësh shqip është më shumë se nder.

**Shkëndije Pacolli**



**PRAXIS FÜR  
PSYCHOLOGISCHE  
BERATUNG**  
Shkëndije Berisha Pacolli



+49 152 33 63 07 73



info@pacolli-praxis.de  
www.pacolli-praxis.de



Boschring 6  
56422 Wirges



# BOOM

*Sabri Fejzullahu  
është klonuar:*

**Quhet  
Arlind Beqiri  
- Sabriano Jr**

*Figurat tona publike  
që e mbajnë epitetin  
gjyshe e gjysh*


*Noizy thotë se  
nuk ka kohë  
për femra!*

*Pse ka fobi nga martesë,  
modelja nga Mitrovica  
me famë në Amerikë?*



# Sabri Fejzullahu është klonuar: *Quhet Arlind Beqiri - Sabriano Jr*

*Zëri i tij është i  
mrekullueshëm  
dhe na duket se  
e kemi dëgjuar  
gjithë jetën, ani  
pse Arlind Beqiri  
është vetëm 22  
vjeç.*



Këngëtari i ri, Arlind Beqiri, është kopje e gjallë e legjendës së muzikës shqipe, Sabri Fejzullahut, për çka nga publiku njihet si “Sabriano Junior”. Arlindi e Sabriu janë si një takim i të njëjtës qenie, por që njëra i takon së kaluarës e tjetra të tashmes. Arlind Beqiri është 22 vjeç, jeton në Mitrovicë. Është shpirt krijues, luftarak e fitues. “Talentin se di të këndoj e zbulova kur isha në qetësi, i vetëm në veturë. Aty fillova të këndoj me këngën që ishte në radio... Dhe, kështu, e befasova edhe veten, sepse unë gjithmonë, e edhe në shkollë, kam thënë se e kam zërin e keq, as në programet e shkollës nuk kam marrë pjesë, e as në recitale, sepse kam menduar se do qeshin me mua, me zërin tim... Një zë i brendshëm një natë më tha të shkoj të grimohem si Sabriu... U grimova dhe pash ngjashmërinë time me legjendën e muzikës shqiptare, këngëtarin Sabri Fejzullahu”, thotë Arlindi, për “takimin” e tij imagjinar me karakterin e tij real artistik. Kënga që Arlind Beqirit i dha krahë dhe e prezantoi te publiku shqiptar ishte ajo me titull “Ti je unë”.

## SABRIUN E KISHTE IDOL QË NË VEGJËLI

Ndërkohë, këngëtari tregon se Sabriun e kishte idol që në vegjëli. “Si i vogël, e kam pasur idol zërin dhe artin e tij, i cili vërehet në

çdo lëvizje apo mimikë. E kam pasur ëndërr ta takoj, ta përqafoj... E, ai takim ndodhi në një natë në Prishtinë. Por, befasia e atij takimi ishte se axha Sabri e kishte menduar një projekt me mua. E, kur më tha, ai moment mu duk si në ëndërr... Ai, pastaj, përgatiti çdo gjë, deri në finalizimin e projektit... Dhe, mu drejtua me frazën: “Ti je unë!”.


## PROJEKTI MË I RI I ARLIND BEQIRIT E SABRIANO JR

Arlind Beqiri - Sabriano Jr sapo i kanë dhënë dritën jeshile projektit më të ri, me hitet e yllit të paperëndueshëm, Sabri Fejzullahu.

“Janë këngë të kënduara nga unë, me orkestrimin e bërë në mënyrë të njëjtë, si ai që i ka bërë në vitet e arta të tij. Axha Sabri i ka zgjedhur këngët dhe unë i kam këndur me zërin magjik të Sabriut, duke u munduar të jap të gjithë potencialin tim vokal.

I kam kënduar me shpirt, që, vërtet, të tregoj se unë do ndjek çdo hap të tij, në karrierën time që më pret. Pra, kështu, do të bëj që legjenda shqiptare të mos harrohet asnjëherë...”, thotë për “Boom” këngëtari i ri, i talentuar dhe interesant, duke shtuar se, në fund, është përherë falënderues ndaj idolit të tij për mikpritjen, për hapjen e derës dhe pranimin në shtëpinë e familjen e tij.

**Nderim Neziri**





# Figurat tona publike që e mbajnë epitetin gjyshe e gjysh

*Një nga epitet më të dashura për çdo njeri është epiteti i gjyshes a gjyshit. E, këtë epitet me krenari e mbajnë disa nga figurat tona publike...*



## XHERALDINA VULA

Edhe Xheri epitetin gjyshe me shumë dashuri e gëzim e priti. Atë e bëri gjyshe vajza e Ledrit dhe Sarës, Poem Blue.

## SHYHRETE BEHLULI

Shyhrete Behluli njihet si një nga gjyshet më të komentuar me shumë nipa e mbesa. Këtë epitet e mbanë me krenari.



## REMZIJE OSMANI

Epitetin gjyshe ia sollën mbesa Ema dhe nipi Joni. Gjyshe Remzija kalon shumë kohë me të dy engjëjt që ia zburkuan jetën.



## SHKURTE FEJZA

Shkurte Fejza është gjyshja e Diellit, nipi i cili ia ndriçoi shtëpinë. Ajo ka shprehur dëshirën se dëshiron të bëhet gjyshe edhe nga nipi a mbesa që do i sjellë djali i saj dhe nusja.





### GILI

Gili është një nga gjyshet më të reja. Aleksii ia dhuroi këtë epitet të ëmbël.



### SEVDAI RADOGOSHI

Aktori dhe komediani i njohur kosovar mori epitetin e gjyshit vitin që lamë pas. U shpreh më i lumtur se kurrë që në duar mban nipin e tij.



### SINAN VLLASALIU

Sinani është gjysh i një nipi dhe dy mbesave. Edhe jeton larg tyre, gjen kohë për t'i vizituar dhe ka raporte të mira me ta.



### SABRI FEJZULLAHU

Artisti Sabri Fejzullahu ka vite që e mbanë me shumë dashuri epitetin e gjyshit. Është gjysh shumë i kujdesshëm dhe kalon kohë të madhe me nipërit e tij.

**Edona Vllasaliu-Bajoku**





## I kujt është ylli i vetëm në “Hollywood Walk of Fame”, që nuk mund ta shkelësh?

Një nga vendet më të vizituara nga turistët në Los-Anxhelos është “Hollywood Walk of Fame”, vend ku mijëra njerëz admirojnë yjet e personaliteteve të ndryshme nga bota e artit, filmit dhe sportit.

Pas më shumë se 26 vjetësh, pasi u vra në Las Vegas, Tupac Shakur ka një yll në “Hollywood Walk of Fame”.

Të mërkurën, miqtë, familjarët dhe

fansat e reperit u mbledhën në ceremoninë e zhvilluar një javë para ditëlindjes së tij.

Motra e Shakurit, Sekyiwa “Set” Shakur, pranoi yllin në emër të tij dhe tha se ndihej e nderuar që ishte atje, duke përfaqësuar familjen.

Sidoqoftë, turistët mund të ecin mbi yjet e personazheve të njohur, si: Majkëll Xhekson, Skarlet Xhonsion, Alfred Hiçkok, e shumë të tjerë...

Megjithatë, ajo që është interesante të theksohet, të gjithë yjet janë të vendosur në tokë, përveç njërit.

### E, I KUJT ËSHTË AI?

Një nga boksierët më të mëdhenj të të gjitha kohëve, Muhamed Ali, mori yllin e tij në vitin 2002 dhe dha leje që emri i tij të përdorej, por me një kërkesë: ylli i tij të vendosej vertikalisht, në mënyrë që askush të mos shkelte mbi të.

Për shkak të fesë islame, nëse dikush do të shkelte yllin me emrin e tij, do të ishte një fyerje. E, kërkesa e tij u pranua.

Kështu, i vetmi yll në “Hollywood Walk of Fame”, që është vertikal, është ylli i boksierit Muhamed Ali, në Teatrin “Dolby” në Los Angeles dhe askush nuk mund ta shkelë



atë.

Sidoqoftë, Muhamed Ali, konsiderohet si një nga boksierët më të mëdhenj në histori.

Pas një beteje të gjatë me sëmundjen e Parkinsonit, vdiq më 3 qershor 2016.

“Boom”





*Noizy flet pa dorëza për jetën e tij profesionale dhe private...*

## Noizy thotë se nuk ka kohë për femra!

“Më pëlqejnë këngët e mia deri kur bëhen publike, sepse më pas i përkasin të gjithëve... E, nëse nuk do më pëlqente ndjesia me artistët, nuk do t'i bëja më. Unë nuk shtirem. Më pëlqen ajo që bëj”, thotë këngëtari.

### NUK KAM KOHË PËR DIKË

Është shumë i komentuar në rrjetet dhe mediet sociale, por shumë pak dimë për jetën personale të Rigels Rajkut.

Ai rrëfen se nuk është në marrëdhënie romantike, pasi nuk ka kohë...

“Tani nuk e kam luksin t'i jap kohën, se këto kohë, tri ditë jam në Shqipëri dhe pjesa tjetër e javës më kalon jashtë shtetit me koncerte.

Nuk di çfarë të bëj më parë. Nuk e kam kohën që duhet t'i kushtoj dikujt”.

Ndërkohë, këngët që Noizy ka sjellë në bashkëpunim me Loredanën, Xhensilën dhe Ylli Limanin, janë bërë hitet më të mëdha, teksa është e pamundur të mos i dëgjosh në veturë, bare apo kudo.

A mendonte Noizy, dikur, se do të ishte ky që është? Përgjigja është - jo.

“Boom”



# Pse ka fobi nga martesa, *modelja nga Mitrovica me famë në Amerikë?*

Është ndër modelet më të famshme shqiptare që jeton dhe vepron përtej oqeanit Atlantik, në SHBA.

Fjala është për mitrovicasen, Lorena Halitin, e cila është mjaft aktive me projekte të ndryshme të modës në Amerikë.

Bukuroshja shpesh zgjedh të bashkëbisedojë me fansat përmes opsionit pyetje-përgjigje, ku disa prej tyre i ka befasuar me përgjigjet që u ka dhënë zeshkania.

Një prej pyetjeve ishte: A do të pranonte të martohej me shqiptar?

“Nuk ka lidhje, se kurrë nuk do të martohej!”, ka pohuar, ndër të tjerash, modelja përmes llogarisë personale në “Instagram”.





# Beart Rexhepi, më i lumtur se kurrë, zbulon njeriun e zemrës

*Beart Rexhepi për një kohë ishte emri më i lakuar në shou-bizin vendor, shkaku i pjesëmarrjes në "Përputhen".*

Pamja, qëndrimi stoik dhe i pandryshueshëm, origjinaliteti që e karakterizonte, e bënë Beart Rexhepin djaloshin e ëndrrave për shumë vajza.

Bearti ka kohë që nuk pranon të japë intervista në media, e aq më pak të flasë për zhvillimet në jetën private, që nuk janë të pakta. Megjithatë, detaje rreth të rejave në jetën sentimentale kanë arritur të përfundojnë në media... Siç dihet, Beart Rexhepi është në lidhje serioze, madje së shpejti do bëhet babë për herë të parë.

Këtë e ka konfirmuar edhe vetë ai, përmes rrjeteve sociale, për të mos lënë kështu hapësirë për thasheteme...



## KUSH ËSHTË FEMRA QË DASHURON?

Më në fund, është zbuluar edhe imazhi i të përzgjedhurës së Beart-it, femrës bukuroshe, me tipare

të theksuara, që së shpejti sjell në jetë një foshnje, një engjëll. Çifti po e shijojnë bashkë pritjen e ëmbël dhe duken më të bukur se kurrë më parë...



# Familja me 13 fëmijë në një dhomë!

*Shqiptarët e Kosovës janë shpallur disa herë si popull i lumtur në botë. Shtrohet pyetja: Kah ajo lumturi?*

Për një shekull shqiptarët kanë kaluar nëpër kanalën e ferrit njerëzor. Serbia organizonte vrasjet e shqiptarëve të Kosovës, duke përzgjedhur ajkën e të rinjve për t'u dhënë plumb në ballë, që të mbetej Kosova pa mbroje në të ardhmen. Por, edhe kur Serbia mendonte se me masakra e vrasje e zhduk popullin shqiptar, ne u rritëm si popull.

E, si arritëm ta bënim këtë?

Danushi (shkurt e thërrisnim Dan), fqinji im, i kishte tetë djem. Të gjithë silleshin nëpër oborr, duke bërë ndonjë punë sado të vogël.

Ai qante nga gëzimi kur shihte se secili mundahej të bënte diçka...

Një mëngjes, xha Luta, e që e kishte vetëm

një djalë, teksa kalon kah shtëpia e Danit, e sheh Danin në oborr duke qarë.

"Ç'ke që qan, o Dan?!", i tha nga larg.

Dhe, pa prituri përgjigje i tha: "T'i ka falë Zoti gjithë të mirat, e ti qan, a?!".

"Gjithë këta djem duan bukë! E, si të mos qaj?!", ia kthen Dani.

"Falënderojë Zotin që t'i ka dhënë gjithë këta djem! A ke dëgjuar se është fikur shtëpia me shumë djem?! As nuk ke dëgjuar dhe as që ke me dëgjuar", ia kthen xha Luta.

Dhe, Danit përnjëherë i ndalën lotët...

## **BUKË, FËMIJË E ZEMËR**

Nuk e kam fjalën për bukëpjekësin Ridvan Muharremin, kur them bukë e zemër.

Fjalën e kam për lumturinë.

Pra, ishim popull i lumtur, duke mos pasur mjaftueshëm as bukë. Një vend i shkatërruar, duke fjetur në tenda najloni...

Por, më Serbia nuk na futet në shtëpia për të na bastisur, kinse në kërkim të armëve...

E, kur u shpallëm si populli më i lumtur në

botë, erdhën njerëz nga shtetet evropiane për ta gjetur lumturinë mes shqiptarëve të Kosovës dhe u befasuan se me çka qenkemi të lumtur...

Ndërkohë, një delegacion evropian e vizitoi një familje me 13 fëmijë, që të shohin se si jeton...

Dhe, kur panë se burri me grua dhe 13 fëmijë jetonte në një dhomë, mbetën të shtangur, meqë asnjëherë nuk kishin parë diç të tillë...

## **QESHJE, KËNGË E VALLE...**

Pra, nuk është me rëndësi si jetojmë dhe në ç'kushte jetojmë. Me rëndësi është se më mbi krye nuk e kemi Serbinë.

Andaj, pse të mos festojmë?

Në çdo kanal televiziv, muzikë, valle e hare... Edhe në rrjete sociale kudo dhe kah do hare...

E, kjo tregon se nuk jemi fare në ngjarje se çka po ndodh te ne dhe me ne!

**Safet Krivaça**



allure®  
BEAUTY



INMODE  
PSE ËSHTE

# MORPHEUS8

THE BEST?

**BËN LIFTING** TË LËKURËS

NXIT PRODHIMIN NATYRAL  
TË **KOLAGJENIT**

**TENDOS** LËKURËN

**HEQ** RRUDHAT

**HEQ** SHENJAT E AKNEVE,  
PORET E ZGJERUARA DHE  
VARJET E LËKURËS

**ZHDUK** DOUBLE CHIN

**SHFAROS** CELULITIN

ËSHTE 10 NË 1, NDOHTA DHE MË SHUMË.





*I dashuri më tha:*

# Bën ç'të duash, veç mos më tradhto!

*Edhe një ditë e re, por unë as që e vërej, ngase ditët për mua më s'kanë kuptim për t'u gëzuar.*

*Sot, përkundër të gjithave, e ndjej zbrazëtinë thellë brenda vetes, e që s'mund t'ma plotësoj askush me asgjë, sepse ranë shoqet e mia dhe ma shkatërruan jetën...*

Isha 18 vjeçe, maturante, kur u takova për të parën herë me Milin. Ishin ditët e një dimri me shumë acar, por mua i ftohti nuk më bënte përshtypje.

## SI NISI GJITHÇKA?

Shkoja shpesh të dajallarët, sepse atje krijova shoqëri shumë të mirë me fqinjën e dajave.

Arsye tjetër pse shkoja shpesh te dajallarët ishte se në shtëpi jetonim me axhallarët në kushte shumë të rënda jetese.

Të vetmit që punonin në shtëpi ishte një axhë imi dhe djali i tij. Të tjerët, që të gjithë, ishin të papunë.

Nganjëherë detyroheshim që javë të tëra të kalonim tek dajallarët, sepse s'kishim ushqim të mjaftueshëm në shtëpi, kurse te ta jeta ishte më e mirë.

## DASHURI NË SHIKIM TË PARË

Ishte ditë vikendi. Erdhi daja për t'na vizituar. Shkova me të te dajallarët.

Dhe, takimin e parë te dajallarët e bëja me Naimen, shoqen time, e cila ishte fqinje me dajallarët e mi.

Atë natë shkova drejt e te Naimja. Aty takova për të parën herë Milin (kështu e thërrisnin Milaimin), e që ishte tezak i Naimes.

Ishte zeshkan, i gjatë, sygjelbër. Ishte tejet i bukur...

U ula përballë tij. Por, duke mos guxuar ta shikoja në sy, e shikoja nganjëherë vjedhurazi...

E vërejta se edhe ai më shikonte vazhdimisht.

Filluam të diskutonim për tema të ndryshme. Ishte shumë i pjekur dhe i matur në fjalët që fliste, përkundër meje që isha e re dhe se nuk isha e informuar.

Atë natë Naimja ishte vetëm me Milin dhe m'u lutën që të flija aty.

Por, edhe unë kisha dëshirë të rrija, sidomos tanimë që kisha arsye, sepse

u njoha me Milin.

Atë natë nuk bëmë gjumë fare, përveç Naimes, e cila nuk mundi t'i rezistojë dot gjumit.

Por, ndihesha në siklet, sepse mbetëm vetëm unë dhe Mili...

Atë natë më tha se më kishte parë shumë herë kur vija te dajallarët, por që asnjëherë nuk ka pasur rastin t'më takoj. Më tha se gjithëherë kishte ëndërruar t'më takonte dhe për këtë, madje, i kishte treguar edhe Naimes, por ajo s'më kishte treguar nga frika se mos e humbiste shoqërinë që kishim krijuar.

Më tregoi gjithçka për veten... Dhe, për çudi, kishte një histori shumë të ngjashme me timen...

Babai i ishte vrarë në luftë. Jetonte me nënën, me një vëlla e një motër. Askush nuk punonte nga familja e tij, përveç tij. Punonte kamerier dhe studionte juridikun.

## PUTHJA E PARË PREJ MILIT...

Atë natë, derisa po bisedonim, ndodhi edhe ajo që kurrë s'e kisha paramenduar: mora puthjen e parë prej tij, aty për aty...

Pra, brenda një nate ndodhi gjithçka: takimi i parë me Milin, por edhe fillimi i lidhjes sonë.

Andaj, edhe isha e lumtur, sepse menjëherë kisha filluar të ndjeja për të diçka të veçantë, një ndjenjë që ma riktheu në jetë çdo pjesë të humbur e të tretur të trupit tim.

Të nesërmen i treguam Naimes. Ajo nuk besonte derisa edhe u puthëm para saj. U befasua.

E, në anën tjetër, ishte shumë e lumtur që na shihte bashkë.

Dhe, po atë ditë Mili u kthye në shtëpi e unë te dajallarët. Pas disa orësh e pashë nga dritarja Naimen teksa vinte me vrap në drejtim të shtëpisë ku isha unë.

Kur erdhi, më tha se Mili ishte në spital...

## E THEREN ME THIKË TË DASHURIN TIM!

Mili, rrugës për në shtëpi, ishte ndalur nga disa shokë të vëllait të tij. I vëllai kishte marrë para hua dhe nuk ua kishte kthyer.

Milit, meqë ishte më i vjetër se i vëllai, ia kishin kërkuar paratë, por ai s'kishte pasur t'ua jepte.

Ata, pastaj, e kishin ther me thikë, duke i shkaktuar plagë të rënda...

Dhe, posa mësova nga Naimja për therjen e Milit, u nisëm të dyja për në spital.

Por, nuk na lejuan të hynim në sallën ku operohej...

Në ato çaste erdhën edhe njerëz të tjerë, që nuk i njihja. Naimja më tha se ishin familja e Milit.

Në mbrëmje, kur u kthyem nga spitali i thashë dajës t'më lejonte sërish të flija te Naimja.

E, realisht, e kalova natën në korridorin e spitalit, duke pritur ndonjë lajm për Milin.

Dhe, nga ajo ditë, çdo ditë e vizitoja në spital. Ishin ditët e netët më të mundimshme që përjetova.

Megjithatë, pas një jave u gjend në shtëpi, kurse pas dy javësh filloi punën përsëri në lokalin e tij, në "Dardani". Pas përfundimit të orarit të punës dilnim çdo mbrëmje në shëtitje dhe shumëkush që na njihnte na e kishte lakmi...

Por, ajo që më gëzonte më së shumti ishin ambiciet e tij për të ardhmen. Thoshte se do bëhej avokat i zoti dhe do të krijonte një të ardhme më të mirë për familjen, për mua dhe fëmijët që do t'i kishim.

## PUTHJET NË ERRËSIRË...

Shumë herë, natën, derisa bëhesha gati për gjumë, vinte te dritarja e dhomës sime dhe më jepte puthje... Kështu, shkuarjen time te dajallarët tashmë e zëvendësoja me daljet jashtë Prishtinës me Milin tim të dashur, i cili, para se te hynte në lidhje me mua, kishte pasur një histori me një vajzë, e që e kishte tradhtuar. Andaj, të vetmen gjë që kërkonte nga unë ishte të mos e tradhtoja...

## SI MË TRADHTUAN SHOQET?

Një javë para se ta përfundoja mësimin në shkollë të mesme, shoqet e mia të klasës kishin vendosur të shkonin në një lokal në periferi të Prishtinës.

M'u luten të shkoja me to, por e dija se Mili do të hidhërohej, sepse më priste

çdo ditë të dilnim bashkë.

E, e hamendur, vendosa të shkoja me shoqe...

Në atë restorant luksoz kishte shumë njerëz të pasur, por të moshuar. Pas nja 10 minutash të qëndrimit tonë atje, në tavolinën tonë erdhën dy burra të moshuar dhe u ulën, thuajse pa na pyetur fare.

Shoqet e mia i njihnin.

Në çast, i rashë pishman që shkova aty, sepse ia kisha dhënë fjalën Milit që nuk do dilja askund pa i treguar. Njëri nga ta m'u ulë afër. Filloi të fliste me mua, duke më pyetur për familjen time.

Ndërkohë, shoqet e mia një nga një largoheshin: njëra në tualet, tjetra për të marrë ajër të pastër jashtë, e treta... Dhe, ato nuk ktheheshin më, edhe pse jashtë u errësua.

E, kur pashë se asnjëra prej tyre nuk kthehej, i dhashë të ngrihem.

Në çast, ai më tha se do më shpinte në shtëpi me veturën e tij.

Por, s'kisha as me çka të kthehesha... Rrugës më tha se ishte i martuar, se kishte fëmijë.

Për çudi, atë natë nuk e takova Milin, e as që erdhi te dritarja ime, siç bënte zakonisht.

Të nesërmen e takova dhe i kërkova falje, por pa i treguar se ku kisha qenë...

Pas dy ditësh te shkolla erdhi ai burri që më ktheu atë mbrëmje në shtëpi me veturën e tij. Më sollti një unazë dhe u mundua t'më puthte.

Në çast u egërsova, ia përplasa unazën në fytyrë, sepse deri në atë moment mendoja se më donte si vajzën e vet dhe kishte dëshirë t'më ndihmonte... Megjithatë, në ato çaste e ndjeva veten të pandershme, tradhtare, vajzë mendjelehtë, që mashtrohej nga pasuria...

## SI PËRFUNDOJ GJITHÇKA?

Nuk di cila nga shoqet e mia e kishte njoftuar Milin me ndejën e asaj mbrëmje, por në ditën tjetër kur e takova, pasi ia përplasa unazën atij të poshtri në fytyrë, Mili gjithçka dinte për atë mbrëmje dhe më qortoi rëndë me fjalët: "Të kam thënë veç me më tradhtuar mos më tradhto!".

**Lirja, Prishtinë**





# Më mirë me e pas burrin *homoseksual sesa dreq!*

## VAKIA E PARË

Të dielën e fundit, meqë nuk kisha punë në Redaksi, vendosa të mos dilja askund, me qëllim që t'i jepja shpirtit pak pushim. Por, sillu e pështillu në shtrat, ndërro një kanal televiziv e ndërro një tjetër, nisi çdo gjë të më bëhej monotone.

Andaj, thashë me vete, po dal deri te shitorja e fshatit dhe aty do e gjej dikë për të ndërruar ndonjë fjalë...

Dhe, teksa afrohem afër shitores, një traktor qëndronte në të kundërtën e shitores dhe dy vetë bënin pazar për blerjen e druve.

"Më vjen keq, axhë, por unë s'kam më shumë se 300 euro të të jap për këto dru. E, nëse pajtohesh me çmim, ngarkohu dhe po shkojmë!", i tha blerësi.

"Hë more, po a e di se kush ngarkohet?! Gomar po më bën mua, a?!", ia ktheu shitësi.

"Më fal, axhë, por unë nuk thashë ashtu!", ia ktheu blerësi.

Unë, meqë isha afër dhe i dëgjova se çka flisnin, desha ta qetësoja sado pak situatën dhe u ofrova edhe më shumë afër tyre dhe thashë:

"O axhë, prit pak, ta them edhe unë një fjalë, se të dy jeni gabim! A je shqiptar?"

"Po, shqiptar jam. A s'po ma sheh plisin,

a?!", më tha me nervozë.

"A e di pse e ka krijuar Zoti shqiptarin? E ka krijuar për ta ngarkuar, që të dëshmojë se sa mund të bajë! Sepse, të gjitha punët e rënda nëpër shtetet e Evropës i bëjnë shqiptarët! A është kështu apo jo?!"

E, gomarin pse e ka krijuar Zoti? E ka krijuar që të ngarkohet, të bajë e të mos flasë! Sepse, gomari nuk di të flasë!", i thashë, që ta përmbyllja këtë temë.

"Pasha besën, qenke i mençur! E, falë teje po ta fali ty, se nuk kish pështu bash lehtë ky dilenxhi!", më tha, kinse edhe ai për ta përmbyllur këtë temë.

## VAKIA E DYTË

Unë, meqë u qetësua gjendja, u ktheva në shtëpi.

Por, teksa isha ende jashtë, dëgjova gruan teksa fliste me dikë brenda se si nuk është mirë të martohen vajzat pa mesit.

Dhe, në çast, mu kujtua një këshillë e tim miku: "Nëse dëshiron të dish se sa dinë gratë, përgjoj teksa flet shoqja me shoqen!".

Andaj, afrohem edhe më shumë afër dritares, që të dëgjoja se ç'flisnin...

Gruaja ime flet e flet dhe nuk di të ndalet... Ndërkaq, fqinja jonë, që është më e vjetër

se gruaja ime, i thotë se më mirë ka qenë në kohën kur jemi martuar me mesitni... Sepse, mesiti i kryente punët krejt dhe veç dita e martesës pritej...

Por, ndërkohë, u dëgjua të fliste edhe një fqinje tjetër.

"A e dini se çka i ka ndodhur tezakes sime, Fitnetes? E fejuan me mesit, por asnjëherë nuk ka dalë me të fejuarin! E, kur është martuar, e ka parë se burri ishte homoseksual!"

Dhe, pas dy muaj martesë me të, është detyruar t'u tregojë në shtëpi. U thotë shkurt: "Më në atë shtëpi nuk shkoj!"

E, tek pas dy muajsh mezi janë ndarë me burra!", tha ajo.

Por, posa e përfundoi muhabetin fqinja jonë, gruaja ime i gjuhët me fjalët:

"Sot ka mundësi secila vajzë ta gjejë burrin vetë. E, pse të martohet me mesit si Fitnetja që e përmende dhe burri t'i del homoseksual?!"

Shyqyr Zotit i imi nuk është homoseksual, por më ka rru dreqi me të! Nuk kemi kënaqësi në martesë!"

Uh, thashë me vete, paska gojë edhe gruaja ime! Sa herë e kam pyetur se a është e kënaqur me mua, i rrudhte krahët!

E unë mendoja se i vinte marre...

S. Murturi

## TRAJTIMET ESTETIKE TË KOKËS DHE QAFES



Mbjellja e  
Flokëve



Blepharoplasty



Facelift



Otoplasty



Rhinoplasty



Ngritje e  
vetullave



Foxy Eyes



Chin  
Liposuction



Chin Implant



Cheek Bones  
Implant



Cantopexy



Lip Lift

Rr. Zef Jubani, Veternik - Prishtinë (Hyrja për në autostradë)

+383 (0) 45 707 744 | +383 (0) 43 707 744





# Flet femra që e priti 5 vjet të dashurin

*“Virgjëria është temë e rëndësishme. Dikush të do se je e virgjër, dikush të do se s’je, e dikush nuk di as vetë se çka do!”, tha Valëza, 25 vjeçe, e cila e ka kryer masterin në Degën e Gazetarisë në Prishtinë.*

“Kur isha në shkollë të mesme, në gjimnazin e Prishtinës, e doja një djalë, i cili aso kohe ishte absolvent në Fakultetin Juridik të Prishtinës.

Kemi kaluar mjaft mirë, por një ditë ai shkoi në Angli. Unë mbeta duke e pritur, sepse premtimi i tij ishte se do të kthehej dhe do të martohemi...

## I KAM MËRZI VAJZAT E VIRGJËRA!

Ditët ecnin, muajt e vitet. Gjatë asaj kohe u mundova të jem besnike. Por, ndërkohë, daja më propozoi të takohesha me një shok të tij për të pirë kafe.

Kjo ishte periudha kur i dashuri im as që më telefononte...

Në fillim e refuzova, por, në fund, disi pranova dhe dola.

Posa filluam të bisedonim, ai, pos të tjerash, më propozoi t’ma tregonte banesën e tij. U shtanga nga ajo e papritur. Nuk u be-soja veshëve se nga ai njeri aq i “kulturuar”

mund të dilnin fjalë të tilla.

Kur e refuzova, ia më pyeti nëse ende jam e virgjër. Unë me krenari i thashë: “Po”.

E, ai, me një zgërdhije, më tha: “Hajt, bre, çika e mirë se nuk qenke për mua! Sepse, unë përtoj me u hyrë këtyre punëve me çika të virgjëra!”

## MUND TË JESH ME MUA NËSE SHKOJMË NË SHTRAT...

Dola dhe u takova edhe me një tjetër, atëherë kur u regjistrova në vitin e parë në master, meqë ai më vardisej, kurse i dashuri im që ndodhej në Angli nuk më telefononte.

Nuk dukej djalë i keq dhe aq më shumë më gëzonte fakti se edhe ai studionte njëjtë si unë.

E, mendoja se studimet do na lidhnin edhe më shumë me njëri-tjetrin...

Kaluan disa muaj dhe filluan edhe kushtet: “Ti mund të jesh me mua nëse shkojmë në

shtrat!”, më tha troç një ditë.

Dhe, u ndodha në udhëkryq: nuk dëshiroja ta humbisja, në radhë të parë, kur i dashuri im nuk më paraqitej nga Anglia, por as të shkoja në shtrat me të nuk dëshiroja. Në fund, u përcaktova për versionin të mos shkoja në shtrat me të dhe pikë. Dhe, brenda dy-tri ditësh përfundoi gjithçka...

## VUAJTJEVE U MËSHOVA SHQELM!

E, pas një pauze të gjatë që nuk m’u paraqit asnjëherë në telefon i dashuri im nga Anglia, një ditë vere ai më thirri në telefonin e shtëpisë dhe ma bëri me dije se është gjallë dhe herë do kur do të kthehej.

Kjo më shtyri që mos të takohem më me asnjë djalë, duke pritur kthimin e tij, i cili edhe ndodhi pas pesë vjetësh”, tha Valëza, e cila tashmë është e martuar dhe bën jetë të lumtur.

V.V.

KENDA

CENTER

BY SHKENDA DUBOVA

Fleksibilitet

Energji

Shëndet më i mirë

-kg

Detox

Gjumë i mirë

**Zgjedhni preferencat**

[www.kendacenter.com](http://www.kendacenter.com)





# Shqiptarja, shefe e sektorit të hetimeve në Norvegji

Shqiptarët në botë kudo po arrijnë të bëhen faktorë me rëndësi, sepse mërgimtarë të shumtë janë bërë sotorie sukcesi në fusha të ndryshme.

Me punë dhe përkushtim kanë arritur të krijojnë autoritet dhe emër sukcesi në shtetet në të cilat ata jetojnë.

E, një nga ta është policja Fadije

Brahimi, e cila që 30 vjet jeton në Norvegji.

Ajo, njëherësh, është shqiptarja e parë që përfundoi universitetin 3-vjeçar për oficerë policie, në një nga institucionet arsimore më të larta policore në botë dhe u emërua shefe e sektorit të hetimeve.

Sukcese!



## Sytë e tu

Herë më mbysin herë më ngjallin  
Herë më shuajnë herë më kallin  
Herë më shtangin herë më dridhin  
Herë më çmendin herë më lidhin

Herë sa ëmbël më qetësojnë  
Herë sa ashpër më tërbojnë  
Herë sa bukur dinë të flasin  
Herë sa tmerrshëm dinë të vrasin

Herë më bëjnë të të dua shumë  
Herë të të urrej deri në pafund  
Herë të të kem kudo me vete  
Herë të të mos shoh kurrë në jetë

Edhe të bukur edhe të rrezikshëm  
Edhe të këndshëm edhe të frikshëm  
Edhe lule edhe ther  
Edhe dritë edhe terr


Shumë të çuditshëm megjithatë  
Përuhu Zotit për këtë dhuratë  
Se të rralla janë ato që mbajnë  
Sy që syve tu u ngjajnë.

**Agron Jashari**



# LAGJJA ELIZA VENDI KU FRYMONI LIRSHËM!

+383 49 509 090



NË FERIZAJ LAGJJA  
MREKULLIA PANORAMA  
KA NJË  
ADRESË



+383 49 601 080

[www.cimaks.com](http://www.cimaks.com)



## MAGJISTARJA

[lindjavdekja@hotmail.com](mailto:lindjavdekja@hotmail.com)



Për hapje të fatit, për stresse, sëmundje depresive, për forcim të bashkëshortësisë, për largim të magjive, për ecje të mbarë të biznesit, për rritje të vetëbesimit dhe për sugjerime e ndihmë me barëra popullore, por edhe për gjithçka për jetë të lumtur

*kontaktoni në këtë email adresë:*

[lindjavdekja@hotmail.com](mailto:lindjavdekja@hotmail.com)

### **A kanë ëndrrat domethënie?**

Përshëndetje zonja magjistare! Jam nënë, 51-vjeçare, jetoj në Gjermani.

Jam adhuruese e leximit të ëndrrave dhe shumë herë kam hasur në Revistën tuaj, "Kosovarja", shpjegime për ëndrrat.

A janë ëndrrat reale dhe a e sinjalizojnë të mirën a të keqen?

### **"A është jeta ëndërr"**

#### **Përgjigje:**

Çdokujt i ndodhë që kur sheh një ëndërr të mirë a të keqe, tërë dita i kalon nën hijen e asaj ëndrre, duke kërkuar nëse do të ndodhë diçka e keqe.

Në një shpjegim më të thellë, ëndrrat janë një lloj misteri, që e mbajnë rob çdo njeri.

Andaj, nuk është e thjeshtë të shohësh një ëndërr. E, aq më shumë kur ajo është një ëndërr e keqe.

Por, ka edhe ëndrra të tilla, të cilat shprehin dashuri dhe kënaqësi. Janë ëndrra të cilat dalin nga shpirtrat që lëvizin natën, ashtu sikur thonë legjendat.

Shpirtrat natën dalin nga trupi dhe bredhin jashtë, për t'u

rikthyer sërish në trupin e vet. Dhe, gjatë atij "ekskursioni", ata shohin lëvizjet dhe vijnë për paralajmërime.

Në vazhdim paraqesim disa nga shembujt brilant, që tregojnë të vërtetën e disa ëndrrave që kanë pasur fund të mirë apo tragjik...

Në fundosjen e "Titanikut, të paktën, tre udhëtarë kishin parë ëndërr fundosjen e anijes gjigante.

Nëna e Gjonit, një nga muzikantët e anijes, para fundosjes së "Titanikut" kishte ëndërruar vetëm ëndrra të tmerrshme. Kjo i kishte ndodhur nënës së Gjon Humesit, 21-vjeçar, një nga tetë muzikantët që bënin muzikë në anije.

Dhe, një orë para nisjes së "Titanikut", djaloshi u kishte treguar shokëve se si e ëma e tij kishte parë si në mjegull përplasjen e anijes me një ajsberg në det, se si i shihte njerëzit duke bërëtitur dhe të vdekur mbi ujë...

E, një nënë tjetër kishte arritur ta ndalte të birin e saj, Isakun, irlandez, meqë tri net rresht kishte parë ëndërr se "Titaniku" përmbitej...

### **Burri nuk ka ndjenja ndaj meje!**

Zonja magjistare, jam grua, jetoj larg Kosovës. Kam probleme me burrë.

Vetëm tre muajt e parë të martesës sonë kanë qenë në rregull. E, nga ajo kohë ai më nuk ka ndjenja ndaj meje!

Fillimisht i ka ikur përgjigjes, duke më thënë "Je shtatzënë e nuk dua të rrezikoj", derisa e pranoi, më në fund, se nuk po na ecë lidhja intime mes nesh!

Unë mundohem ta kuptoj atë, por ofendimet që m'i bën po më lëndojnë shumë.

Të lutem, si të veprojmë me të?

**"Pa shifër"**

### **Përgjigje:**

Ti je ajo që e siguron ekzistencën e familjes dhe punon edhe për të. Do të thotë, ai nuk punon. Këtu kemi një ç'përputhje mes jush.

Ai është burrë dhe nuk punon, e qon kohën kot, edhe pse e ka fuqinë për punë, ndërsa ti punon edhe që je nënë dhe ke fëmijët që kanë përkujdesje ndaj teje si kurrë ndonjëherë tjetër.

E, rebalancimi mes jush është se ai qëndron në banesë kur ti punon dhe del me shoqëri të ndryshme.

Do të thotë, të paktën, dhjetë orë në ditë është pa ty!

E, fakti se të xhelozon dhe përflaket nga ndjenjat, tregon se i ka elementet e mundësive për aktivitet intim, por mund të harxhohet diku tjetër!

Ndërkaq, krejt çka i mbetet për

*ty është ofendimi dhe sharja! E, nëse thotë se ka probleme ndjenjash për aktivitet intim me ty, duhet të konsultoheni me ekspertin mjekësor adekuat, e që në vendin ku jetoni ka sa të duash dhe ai u jep këshillat e nevojshme.*

## **Pse jemi as të ndarë e as të bashkuar?**

Jam nënë e dy fëmijëve, jetoj në Zvicër.

Kam probleme me burrë, por nuk di pse kanë lindur problemet, derisa ne nuk kemi pasur asgjë të pakalueshme. Mendoj se ende duhemi. E, ajo që më brengos më së shumti janë fëmijët.

Fëmijët nuk heqin dorë nga babai i tyre.

E, ai i trajton sikur kur ishim bashkë: i merr dhe i kthen. Çka po ndodh ndërmjet nesh?

## **“Ishim burrë e grua”**

### **Përgjigje:**

*Në mes jush kanë hyrë inatet dhe janë bërë kancer bashkëshortor!*

*Ju nuk keni asgjë të madhe për të qenë të ndarë, por keni gjëra të cilat nuk keni fuqi t'i kaloni. Të dy e keni ndjenjën e fajësisë për njëri-tjetrin.*

*Të dytë keni gabime.*

*Sidoqoftë, është bërë modë e kohës që brezi juaj shumë shpejt po i shkatërrojnë bashkëshortësitë, ndërsa raportet tuaja po krijojnë fëmijë sociopatikë!*

*Lëreni inatet nëse doni ribashkim!*

## **Nuk po mund ta gjej rrugën e jetës!**

Jam burrë, 47 vjeç, jetoj në Prishtinë.

Kam qenë një kohë në Gjermani, ku edhe e kam qëndrimin e përhershëm, por që dy vjet jetoj në Kosovë.

Më ka humbur rruga në oborr, siç thuhet në popull!

Kam bërë gjithmonë mirë dhe nuk e meritoj një gjendje në të cilën ndodhem.

Më janë mbyllur të gjitha rrugët e jetës: Nuk më punohet, nuk jam i kënaqur e as i lumtur me asgjë që kam krijuar deri tash.

Çka sheh syri yt për mua, zonjë e nderuar?

### **“Ledri”**

### **Përgjigje:**

*Çdo kërkesë e njerëzimit ndërlihet me fatin. Fati është në çdo problem të jetës, qëkur zgjoheni e deri kur flini.*

*Njerëzit, kur janë ngushtë, i kërkojnë dy gjëra:*

*Zotin dhe fatin!*

*Dëshirat janë fushë për aksion dhe te ju është fikur, pikërisht, vullneti për të ecur në fushat e eksplorimit.*

*Ju keni magji.*

*E, dëshmitë do t'i gjeni në shtëpinë tuaj ku jetoni sot.*

*Në dhomën ku flini i keni tri këmisha të prera dhe të stërpikura me pika gjaku.*

*Nxirrni nga ormani dhe hidhni në bërllok!*

*E, pas një kohe do të rikthehet çdo gjë në vendin e vet...*

## **PËR LEXUESIT E DIASPORËS**

Pyetjet tuaja dërgoni me postë në adresën: “Kosovarja”, fahu postal 18, 10 000, Prishtinë, Kosovë.

## **A na ka bërë ndokush magji?**

Jemi familje me gjendje të mirë financiare. Kuptohet, falë vëllait në Londër.

Unë i kam mbushur 40 vjet dhe ende s’e kam gjetur fatin e jetës.

Kam oferta, por pa fat.

Babanë e kam të sëmure që moti dhe del herë-herë prej kontrollit. Por, kohëve të fundit i është shpeshtuar shumë.

Bëhet agresiv dhe kërkon konflikt me mua!

Andaj, dy herë e kam lëshuar shtëpinë për t’i ikur problemit me të.

Kemi dyshime se dikush na ka bërë magji...

### **“Magjia”**

### **Përgjigje:**

*Ashtu qysh i keni shënuar gjërat në letër, realisht del se dikush mund t’u ketë bërë diçka të keqe.*

*Mund të shprehet dyshimi për gjëra të këqija në shtëpi, meqë u kanë përcjell gjërat negative, përkundër gjendjes së mirë financiare.*

*Këshilla ime është të më*

*paraqiteni në e-mailin tim*

*lindjavdekja@hotmail.com për bashkëbisedim, për zgjidhje të duhur.*





# DENTFIX

ORDINANCA STOMATOLOGIJE



**SHERWOOD**  
Resorts and Hotels



**GREENWOOD**  
Resorts and Hotels

*feel the legend*

**SHERWOOD**  
exclusive Kemer

**SHERWOOD**  
exclusive Lara

**SHERWOOD**  
Dreams Resort

**3UE**  
TUI BLUE  
Beach

**SHERWOOD**  
Premio Hotel

**GREENWOOD**  
Kemer Resort

**GREENWOOD**  
Suites Resort

[www.sherwoodhotels.com.tr](http://www.sherwoodhotels.com.tr)